

V E N D I M
Nr. 413, datë 3.9.1999

**PËR “HAPJEN E LLOGARISË “PËR FINANCIMIN E PROJEKTIMIT DHE TË
NDËRTIMIT TË AKSIT RRUGOR DURRËS – KUKËS – QAFË MORINË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pranë Bankës së Kursimeve të hapet llogaria në lekë dhe në valutë “Për financimin e projektimit dhe të ndërtimit të aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë”, ku mund të depozitohen kontributet nga individë, shoqëri tregtare apo institucione financiare vendase ose të huaja.

Fondi që do të krijohet, do të përdoret me qëllim financimin e studimit, të projektimit dhe të ndërtimit të aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë.

Ngarkohet Banka e Kursimeve të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për publikimin e numrit të llogarisë si në lekë, ashtu edhe në valutë, brenda dhe jashtë vendit.

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të marrë të gjitha masat e nevojshme për hartimin e studimit dhe të projekteve të nevojshme për ndërtimin e aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë.

Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë të marrë masat e nevojshme për gjetjen e burimeve të huaja të financimit për studimin, projektimin dhe ndërtimin të aksit rrugor Durrës – Kukës – Qafë Morinë.

Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko